



DEKLARATË PRELIMINARE

Zgjedhjet parlamentare të 6 tetorit, të administruara sipas standardeve më të larta, të paraprirra nga një fushatë dinjitoze zgjedhore

Prishtinë, 8 tetor 2019

Përmbledhje e të gjeturave kryesore

- Koalicioni i organizatave vendore për vëzhgimin e zgjedhjeve “Demokracia në Veprim” vlerëson që zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 6 tetorit janë zhvilluar në frymë të qetë dhe demokratike, pa ndonjë parregullsi apo incident serioz që do të mund të cenonte integritetin dhe besueshmërinë e publikut ndaj procesit zgjedhor në tërësi. Zgjedhjet janë administruar sipas standardeve më të larta dhe në harmoni me kornizën ligjore.
- Dita e zgjedhjeve, respektivisht procesi i votimit dhe numërimit në përgjithësi është zhvilluar normalisht dhe në frymë të qetë, pa incidente serioze. Publikimi i rezultateve preliminare dhe daljes në zgjedhje nga KZQ-ja brenda një periudhe të shkurtë, ka ndikuar në rritjen e transparencës së procesit.
- Korniza ligjore që rregullon organizimin, administrimin dhe mbarëvajtjen e procesit zgjedhor nuk ka ndryshuar në këto zgjedhje. Reforma zgjedhore, ndonëse e filluar në vitin 2011, ka mbetur e papërfunduar si rezultat i mungesës së vullnetit politik. Puna e nisur së fundmi nga Komisioni ad-hoc për Forcimin dhe Përmirësimin e Procesit Zgjedhor për t’i adresuar mangësitë teknike në administrimin e zgjedhjeve, ishte ndërprerë si rezultat i shkuarjes në zgjedhje të parakohshme. Këto mangësi do të duhej të trajtoheshin me prioritet nga legjislatura e re.
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, por dhe Komisionet Komunale Zgjedhore, kanë shënuar përmirësim të ndjeshëm sa i përket transparencës lidhur me funksionimin e tyre. Ato kanë njoftuar në vazhdimësi për mbajtjen e takimeve, por edhe kanë ndarë dhe publikuar materialet përkatëse me të gjitha palët e interesit.
- KQZ-ja, përkundër afateve të shkurtuara, ka arritur t’i përmbyllë të gjitha aktivitetet dhe operacionet zgjedhore pa vonesa. Po ashtu, KQZ-ja ka arritur të adresojë disa nga mangësitë nga proceset e kaluara, sidomos çështjen e vlefshmërisë së dokumenteve të nevojshme për identifikim të votuesve. Më anë të një udhëzimi, KQZ kishte qartësuar se vetëm dokumentet e lëshuara nga institucionet Republikës së Kosovës janë dokumente të vlefshme të identifikimit. Ky vendim ishte apeluar deri në Gjykatën Supreme nga ana e Listës Serbe, mirëpo vendimi i KQZ-së kishte mbetur në fuqi.



- Përfaqësimi i grave në trupat për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve mbetet në nivele relativisht të ulëta. Zotimi i subjekteve politike i vitit 2015, për garantim të përfaqësimit të grave në trupat menaxhuese të zgjedhjeve në shkallën 40%, nuk është përmbushur.
- Certifikimi i subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre ka rrjedhur normalisht dhe nuk janë shfaqur ankesa nga asnjë palë lidhur me këtë proces. Të gjitha 25 subjektet politike që kanë aplikuar, janë certifikuar nga KQZ-ja. Ndërsa, nga numri fillestar i kandidatëve të dërguar nga subjektet politike, ka pasur disa ndryshime minore, duke ulur numrin e kandidatëve nga 1,070 në 1,067 sosh. Subjektet politike kanë respektuar vetëm kriterin minimal të përfshirjes së grave në lista. Vetëm 343 nga gjithsej 1,067 kandidatët e certifikuar ishin gra. KQZ-ja në këto zgjedhje kishte vendosur që renditja e subjekteve politike në fletëvotim të fillojë nga numri 111 e tutje, duke evituar kështu garën e pabarabartë dhe diskriminimin e kandidatëve brenda listave të subjekteve politike.
- Fushata zgjedhore në përgjithësi ishte dinjitoze dhe u zhvillua në frymë të qetë dhe konkurruese, me pjesëmarrje të konsiderueshme të qytetarëve dhe pa incidente madhore. Në komunat me shumicë serbe ku garuan subjektet politike nga ky komunitet, fushata nuk ishte në përputhje me standardet për një garë të lirë dhe të barabartë. Subjektet politike garuese përballë Listës Serbe u intimiduan, ndërsa qytetarëve iu bë presion të votonin për Listën Serbe.
- Subjektet politike, sidomos ato në pozitë në nivelin qendror apo atë lokal, kanë vazhduar përdorimin e resurseve publike gjatë fushatës. Në mbi 10% të aktiviteteve të fushatës të monitoruar nga DnV-ja, është hasur një dukuri e tillë, ku janë përdorur veturat zyrtare dhe shërbyesit civil për qëllime të fushatës.
- Prania e fëmijëve në fushatë mbetet e lartë dhe është evidentuar në çdo ditë të fushatës. Pjesëmarrja e tyre ka qenë spontane në shumicën dërrmuese të aktiviteteve, por janë evidentuar edhe raste të pjesëmarrjes së organizuar. Rregulla zgjedhore në lidhje me fushatën zgjedhore është ndryshuar nga KQZ-ja në ditën e dytë të fushatës zgjedhore. Plotësim-ndryshimi i rregullës bazë është bërë në funksion të sqarimit të dispozitave në lidhje me pjesëmarrjen e fëmijëve dhe shërbyesve publik në fushatë. Megjithatë, një ndryshim i tillë është dashur të bëhet para fillimit të fushatës.
- Subjektet politike nuk treguan vullnet për transparencë sa i përket financave dhe shpenzimeve të tyre në fushatë. DnV-ja, para fillimit të fushatës kishte kërkuar nga subjektet politike që të tregojnë për shumat që ata planifikojnë t'i shpenzojnë në fushatë, mënyrën e financimit, udhëheqësit e fushatës dhe të tjera. Prej 26 subjekteve politike të cilave ju dërgua kjo kërkesë, vetëm pesë prej tyre u përgjigjën pozitivisht. Për më tepër, shpenzimet e subjekteve politike të bëra jashtë kornizës formale të fushatës zgjedhore, do të mbeten të pa raportuara nëse subjektet politike vazhdojnë t'i keqinterpretojnë dispozitat ligjore lidhur me Raportin e Deklarimit Financiar të Fushatës së Subjektit.
-



- Nga monitorimi që iu është bërë tetë kanaleve televizive (gjashtë shqiptare dhe dy serbe), del se këto medime në kronikat e tyre zgjedhore kanë ofruar hapësirë të përafërt për subjektet e mëdha politike, ndërkaq më pak hapësirë për subjektet e vogla. Gjetjet tregojnë që më së shumti mbulueshmëri tek televizionet në kronika zgjedhore ka pasur LDK-ja me 206 minuta, PDK-ja me 201 minuta, Lëvizja Vetëvendosje me 197 minuta, Koalicioni AAK-PSD me 185 minuta, Koalicioni NISMA-AKR-PD me 160 minuta, Lista Serbe me 122 minuta dhe partitë tjera me 93 minuta. Disa nga kanalet televizive kanë shfaqur edhe spote reklamuese të kandidatëve të subjekteve politike në kohën kur kishte debate zgjedhore
- Radio Televizioni i Kosovës ka treguar njëanshmëri sa i përket mbulueshmërisë së aktiviteteve zgjedhore të subjekteve politike. Të gjitha tubimet e PDK-së janë transmetuar edhe në televizion, por edhe 'livestream' në faqen zyrtare të RTK-së në Facebook. Komisioni i Pavarur i Mediave, edhe gjatë këtyre zgjedhjeve nuk arriti që të jetë efikas sa i përket sanksionimit të shkeljeve të mediave gjatë fushatës zgjedhore.
- Gratë kanë qenë më pak të pranishme në media në kronika zgjedhore dhe në spote publicitare të subjekteve politike. Faqet zyrtare të partive politike në rrjetet sociale u kanë dhënë shumë më pak hapësirë grave.
- Disa nga dukuritë që përsëriten vazhdimisht në proceset zgjedhore në Kosovë, të tilla si numri i shtuar i votuesve me asistencë, pasaktësia e listës së votuesve dhe vështirësitë në gjetjen e Qendrës së Votimit apo vendvotimeve, janë përsëritur edhe në këto zgjedhje. Po ashtu, janë evidentuar edhe raste të fotografimit të votës, bërjes publike të saj dhe qëndrimit të më shumë se një personi prapa kabinës së votimit.
- Në këto zgjedhje, janë evidentuar raste të votuesve të cilët janë identifikuar me dokumente të vlefshme, por me afat të skaduar. Ndërsa, në lidhje me identifikimin e votuesve me dokumente të shteteve tjera, KQZ-ja ka lëshuar një udhëzim i cili ka arritur të sqarojë këtë çështje dhe të evitojë parregullsitë në terren.
- Shqetësues edhe në këto zgjedhje mbetet fenomeni i numrit shumë të madh të fletëvotimeve të pavlefshme. Edhe në këto zgjedhje, në bazë të rezultateve të deritanishme janë evidentuar mbi 40 mijë fletëvotime të pavlefshme, që korrespondon me trendin e cikleve paraprake zgjedhore. KQZ-ja duhet t'i kushtojë më shumë vëmendje kësaj çështje, duke hulumtuar shkaktarët kryesorë të këtij numri të madh të fletëvotimeve të pavlefshme, nëpërmjet auditimit të tyre.
- Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) ka vepruar me profesionalizëm dhe në mënyrë të paanshme në trajtimin e ankesave dhe apeleve, duke respektuar afatet kohore.



Konteksti politik i zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës

Për të katërtën herë radhazi në më pak se dhjetë vjet, qytetarët e Kosovës janë ballafaquar me zgjedhje të parakohshme parlamentare, këtë herë pasi kryeministri Ramush Haradinaj dha papritmas dorëheqje nga posti i tij me 19 korrik të vitit 2019. Dorëheqja e kryeministrit Haradinaj erdhi si rrjedhojë e ftesës për t'u marrë në pyetje nga Dhomat e Specializuara të Gjykatës për krimet e supozuara të luftës në Kosovë, me seli në Hagë. Haradinaj pranoi të intervistohet nga Dhomat e Specializuara të Kosovës ndërsa justifikoi dorëheqjen e tij me qëllimin që të paraqitej para prokurorit special si një qytetar i zakonshëm i Kosovës dhe jo si shefi i ekzekutivit të vendit.

Ndonëse shumë qytetarë e duartrokitën veprimin e tij, subjektet opozitare e analistë politikë e konsideruan dorëheqjen e tij si një manovër politike që synonte tërheqjen e votës popullore, veçanërisht pasi kishte "nuhatur" mobilizimin e partive opozitare për të thirrur një mocion mosbesimi kundër qeverisë së tij. Në deklaratën e tij të dorëheqjes, Kryeministri Haradinaj i kërkoi Presidentit Hashim Thaçi që të fillojë konsultimet me partitë dhe të caktojë datën për zgjedhje të parakohshme, ndërsa bëri të qarta edhe synimet e tij për të kandiduar përsëri për pozitën e Kryeministrit.

Pas dorëheqjes së kryeministrit Haradinaj, më 2 gusht, në përputhje me nenin 95 të Kushtetutës, Presidenti Thaçi i kërkoi zyrtarisht liderit të koalicionit fitues nga zgjedhjet paraprake, Kadri Veseli, të propozojë kandidatin e ri për të mandatuar formimin e Qeverisë së re. Sidoqoftë, në një përgjigje të menjëhershme, Veseli informoi Presidentin se koalicioni PAN nuk do të emëronte një mandatar të ri, si dhe në vend të kësaj zgjodhi zgjedhje të parakohshme.

Kryesia e Kuvendit më 5 gusht u dakordua për caktimin e seancës për shpërndarjen e Parlamentit, me 22 gusht. Siç pritej, mocioni për shpërndarjen e legjislaturës së gjashtë u mbështet me gjithsej 89 vota. Më 26 gusht, Presidenti Thaçi nënshkroi dekretin në mbështetje të shpërndarjes së Parlamentit ndërsa zgjedhjet u caktuan me 6 tetor 2019.

Shpërndarja e parlamentit pushoi edhe aktivitetin e legjislaturës së gjashtë, e konsideruar si ndër më të dobëtat nga të gjitha legjislaturat sa i përket performancës. Kjo legjislaturë u karakterizua me probleme të shumta në funksionimin e rregullt të jetës parlamentare, probleme këto të cilat ishin shfaqur qysh në seancën konstituive të saj. Kryetar i Kuvendit ishte zgjedhur Kadri Vesli, ndërsa kandidati i propozuar për kryeministër, Ramush Haradinaj, u zgjodh me 61 vota. Ndryshe, Qeveria Haradinaj njihet si më e madhja në Kosovës deri më sot, e cila numëronte gjithsej pesë zëvendësministra, 21 Ministra dhe rreth 80 Zëvendësministra.

Koalicioni qeverisës ishte trazuar, sidomos pasi Qeveria e Kosovës vendosi tarifën 100% për produktet serbe dhe boshnjake në nëntor të vitit 2018. Tarifa kishte kontribuar në ngecjen e dialogut midis Kosovës dhe Serbisë dhe rritjen e presionit ndërkombëtar ndaj dy qeverive për të rifilluar bisedimet. Përçarjet brenda koalicionit qeverisës vazhduan të thelloheshin, pasi që Veseli, Kryetar i Parlamentit dhe drejtuesi i PDK-së, kishte propozuar një pezullim të përkohshëm të tarifës për mallrat serbe, e cila u kundërshtua fuqishëm nga kryeministri Ramush Haradinaj. Kjo situatë përshkallëzoi edhe më tepër raportet mes partnerëve të koalicionit, të cilët filluan edhe publikisht të kundërshtonin njëri-tjetrin rreth taksës dhe çështjeve që kryesisht kishin të bëjnë me dialogun dhe raportet me bashkësinë ndërkombëtare.

Zgjedhjet e parakohshme të vitit 2019 përsëri u organizuan pa përfundimin e reformës zgjedhore. Komisioni ad-hoc parlamentar i krijuar për të trajtuar aspektet teknike të zgjedhjeve nuk ka arritur japë rezultatet e parapara, për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandatit. Për më tepër,



procesi i reformës është konsideruar si një nga dështimet kryesore të të gjitha legjislativave që nga viti 2011 dhe i atribuohet mungesës së vullnetit të partive politike dhe zgjedhjeve të parakohshme.

Korniza ligjore

Sistemi zgjedhor për zgjedhjet e përgjithshme është i përcaktuar sipas Kushtetutës së Kosovës dhe disa ligjeve specifike që rregullojnë në tërësi procesin zgjedhor. Aktet normative të cilat rregullojnë procesin e organizimit, administrimit dhe mbarëvajtjes së zgjedhjeve janë Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, Ligji për Financimin e Subjekteve Politike, Kodi Penal i Republikës së Kosovës si dhe rregullat zgjedhore të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Sistemi që aplikohet për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës është sistem proporcional i përfaqësimit, me lista të hapura të kandidatëve nga subjektet politike. Republika e Kosovës është një zonë e vetme zgjedhore, ku të gjitha subjektet politike garojnë për 120 ulëset e Kuvendit të Kosovës, prej të cilave 10 janë të garantuara për subjektet politike që përfaqësojnë komunitetin serb, ndërsa 10 të tjera janë të garantuara për subjektet politike që përfaqësojnë komunitetet tjera jo-shumicë. Pragu zgjedhor për të gjitha subjektet politike që garojnë në zgjedhje është 5%. Pra, çdo subjekt duhet të fitojë të paktën 5% të votave të vlefshme për të fituar ulëse në Kuvend. Pragu zgjedhor nuk aplikohet për subjektet politike të cilat garojnë për ulëset e garantuara.

Bazuar në aktet ligjore në fuqi, Kosova aplikon kuotë të dyfishtë gjinore. Kuota e parë aplikohet në listat e dorëzuara nga subjektet politike, që parasheh që të paktën 30% e listës së secilit subjekt politik duhet të jetë i përbërë nga gjinia më pak e përfaqësuar. E njëjta kuotë zbatohet edhe në ndarjen e ulëseve në Kuvendin e Kosovës.

Puna e trupave për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve

Që nga shpallja e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës, deri në ditën e mbajtjes së tyre, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka mbajtur gjithsej 21 mbledhje. Në përgjithësi, puna e KQZ-së ka qenë transparente, ndërsa mbledhjet përgjithësisht janë mbajtur në frymë profesionale dhe konsensuale. Me raste ishin shfaqur edhe mospajtime midis anëtarëve, sidomos për përbërjen e KKZ-ve. Gjatë kësaj periudhe, KQZ-ja ka funksionuar pa përbërje të plotë, si rezultat i mos emërimit të një nga anëtarëve të KQZ-së, propozimi i të cilit i takon koalicionit PAN. Pothuajse të gjitha mbledhjet e KQZ-së janë paralajmëruar për vëzhguesit dhe palët tjera të interesit, si dhe janë ofruar pjesa më e madhe e dokumenteve apo materialeve .

Afatet kryesore të aktiviteteve zgjedhore për këto zgjedhje janë miratuar qysh në mbledhjen e parë të KQZ-së pas shpalljes së Ditës së zgjedhjeve. Disa prej këtyre afateve ishin ndryshuar, kryesisht si rezultat i garantimit të mbarëvajtjes së rregullt të procesit, apo edhe pamundësisë për t'i përmbyllur ato në kohë. Po ashtu, si rezultat i natyrës së parakohshme të zgjedhjeve, KQZ-ja kishte marrë vendim për shkurtimin e afateve për disa aktivitete zgjedhore.

Gjatë fazës së parë të përgatitjeve për organizimin e zgjedhjeve, KQZ-ja ishte ballafaquar me sfida në aspektin e sigurimit të mjeteve financiare për operacionet e parapara zgjedhore. Ndonëse KQZ-ja kishte miratuar buxhetin prej 5,7 milion euro për organizim të zgjedhjeve, alokimi i tyre u bë me një javë vonesë për shkak të paqartësisë lidhur me kompetencat e kabinetit qeveritar pas dorëheqjes së kryeministrit.

Në funksion të garantimit të integritetit dhe rritjes së cilësisë së organizimit të procesit zgjedhor në katër komunat veriore, KQZ-ja kishte marrë vendim për përfshirjen e misionit të OSBE-së, me rol të



kufizuar në ofrimin e këshillave për Komisionet Komunale Zgjedhore dhe Këshillave të Vendvotimit në këto katër komuna.

Përbërja e Komisioneve Komunale Zgjedhore (KKZ) ka qenë një nga çështjet për të cilat ishin shfaqur mospajtimet e para mes anëtarëve të KQZ-së, gjegjësisht mes anëtarëve që përfaqësojnë subjektet politike që kanë qenë në pozitë dhe atyre në opozitë. Edhe pse aktet ligjore parashohin që KKZ-të duhet të përbëhen nga anëtarë që nominohen nga subjektet politike që kanë kaluar pragun në zgjedhjet paraprake, e që në këtë rast vetëm tri subjekte (Koalicioni PAN, Koalicioni LA dhe Lëvizja Vetëvendosje) plotësonin këtë kriter, KQZ-ja kishte marrë vendim për emërimin e anëtarëve të KKZ-ve, duke u bazuar në formulën ku e drejta e nominimit ju njihej edhe partive politike që kishin garuar brenda koalicioneve përkatëse. Ky vendim ishte miratuar me shumicë të votave, por tre përfaqësuesit e subjekteve opozitare kishin votuar kundër.

Përfaqësimi i grave në Komisionet Komunale Zgjedhore, edhe në këto zgjedhje mbetet në nivele shumë të ulëta. Nga gjithsej 257 anëtarë të këtyre komisioneve, vetëm 42 prej tyre, apo rreth 16%, janë gra. Kurse, sa i përket kryesuesve të këtyre komisioneve, vlen të përmendet që vetëm katër nga gjithsej 38 kryesuesit e KKZ-ve janë gra.

Marrë parasysh paqartësitë që janë shfaqur në ciklet e kaluara zgjedhore lidhur me dokumentet për identifikim të votuesve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e mbajtur më 9 shtator 2019, kishte miratuar një udhëzim për KKZ-të dhe KVV-të, për qartësimin e dispozitave lidhur me dokumentet e vlefshme me të cilat mund të votohet. Udhëzimi i lëshuar 26 ditë para ditës së zgjedhjeve, obligonte trupat përgjegjëse për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve që të pranojnë si të vlefshme vetëm dokumentet e lëshuara nga institucionet e Republikës së Kosovës, të parapara me nenin 90 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Kundër këtij vendimi kishte votuar dhe reaguar anëtari i KQZ-së nga radhët e Listës Serbe. Ky subjekt politik kishte apeluar këtë vendim në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa. Pas refuzimit të këtij apeli nga ana e PZAP-së, Lista Serbe kishte dërguar këtë çështje edhe në Gjykatën Supreme, e cila kishte rrëzuar përfundimisht pretendimet për anulimin e këtij udhëzimi.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kishte miratuar edhe dizajnin e fletëvotimit dhe dizajnin e broshurës së kandidatëve, të cilat vizuelisht ishin të njëjta me dizajnet e zgjedhjeve të kaluara. KQZ-ja ka shtypur 1,817,200 fletëvotime apo 7% më pak se numri i votuesve të regjistruar. Po ashtu, për këto zgjedhje është miratuar edhe një formular i ri për paraqitjen e rezultateve preliminare të subjekteve politike. Ky formular nuk është dokument zyrtar, mirëpo përdorimi i tij është i limituar vetëm në funksion të paraqitjes më të shpejtë të të dhënave për rezultatet e subjekteve politike.

Informimi dhe edukimi i votueseve nga KQZ u bë me vonesë, pasi tenderi përkatës fillimisht ishte anuluar. Kontrata për fushatën e informimit, vlera e së cilës është mbi 210 mijë euro, ishte dhënë më 19 shtator, duke lënë kështu një periudhë prej vetëm dy javësh për implementimin e Strategjisë së KQZ-së për Informim Publik. Ndër tjera, KQZ-ja kishte marrë vendim për miratimin e sloganit të këtyre zgjedhjeve “Votojmë për të ardhmen tonë!”. Ky slogan ishte ndryshuar, për shkak të ngjashmërisë me sloganin e një prej subjekteve politike. Slogani përfundimtar që është proklamuar ishte “Trego fuqinë tënde – VOTO!”.

Për organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor në ditën e zgjedhjeve, KQZ-ja ka angazhuar 17 mijë persona staf në Këshillat e Vendvotimeve. Si staf ndihmës, nga KKZ-të janë përfshirë mbi 9 mijë persona, ndërsa janë angazhuar rreth 300 anëtarë në 110 ekipet mobile që KQZ-ja ka pasur në dispozicion.



Certifikimi i subjekteve politike dhe kandidatëve

Për zgjedhjet e 6 tetorit, KQZ-ja ka certifikuar gjithsej 25 subjekte politike. Prej tyre, katër ishin koalicione, 20 parti politike dhe një kandidat i pavarur. Ndërsa, numri i përgjithshëm i kandidatëve të certifikuar për të marrë pjesë në zgjedhje është 1,067 sosh. Numri fillestar i kandidatëve të subjekteve politike ka qenë 1,070, por pas decertifikimit nga PZAP-ja dhe zëvendësimit të disa kandidatëve, ky numër ka zbritur në 1,067. Nga ky numër i kandidatëve, 725 kandidatë janë burra, ndërsa vetëm 343, apo 32%, janë gra.

Sipas ndarjes në baza etnike të subjekteve politike që janë certifikuar, përpos kandidatit të pavarur që ishte nga komuniteti boshnjak, shtatë ishin subjekte politike nga komuniteti shqiptar, katër nga komuniteti serb, tri nga komuniteti boshnjak, tri nga komuniteti goran, tri nga komuniteti ashkali, dy nga komuniteti rom dhe një subjekt nga komuniteti turk dhe ai egjiptian.

Një nga risitë e këtij procesi ka qenë miratimi i udhëzuesit për tërheqjen e shortit për renditjen e subjekteve politike në fletëvotim, në të cilin ishte paraparë që renditja e subjekteve të bëhet nga numri 111 e tutje. Me këtë vendim, i cili është në përputhje me kërkesat e shoqërisë civile, KQZ-ja ka garantuar garë të barabartë dhe mos diskriminim të asnjë prej kandidatëve brenda listave të subjekteve politike, që si fenomen ishte shfaqur përgjatë proceseve të kaluara zgjedhore.

Shorti për renditjen e subjekteve politike në fletëvotim ishte hedhur më 17 shtator 2019, duke sjellë renditjen si në vijim: PLE – 111, PDK – 112, PAI – 113, SDA – 114, PKS – 115, PDAK – 116, PZG – 117, NDS – 118, AAK-PSD / KOALICIONI 100% KOSOVË – 119, SLOBODA – 120, SLS – 121, NISMA—ALEANCA KOSOVA E RE—PARTIA E DREJTËSISË – 122, JGP – 123, VAKAT – 124, FJALA – 125, LËVIZJA VETËVENDOSJE – 126, KDTP – 127, PRBK – 128, PEK – 129, KNRP – 130, IRDK – 131, ESMIR KASI – 132, GIG – 133, LDK – 134 dhe SRPSKA LISTA – 135.

Lista e votuesve, Qendrat e Votimit dhe vendvotimet

Lista preliminare e votuesve, që është bazuar në ekstraktin e parë të Regjistrin Qendror Civil ka përfshirë 1,972,466 votues. Sipas planit operacional të KQZ-së, votuesve iu ishte dhënë afat prej vetëm tre ditësh, prej të cilave një ishte ditë vikendi, për kundërshtimin e listës së votuesve. Ky afat i shkurtër kishte ndikuar që qytetarët të mos kenë hapësirën e nevojshme kohore për të sfiduar listën.

Ndërsa, Lista Përfundimtare e Votuesve për këto zgjedhje ka përfshirë gjithsej 1,937,868 votues, apo 111,733 më shumë votues nga zgjedhjet e kaluara. Votues që kanë arritur moshën për të votuar dhe që do të mund të votojnë për herë të parë janë 87,180 votues. Janë gjithsej 24,553 votues që nuk kanë qenë paraprakisht në listën e votuesve, por që janë përfshirë për herë të parë në Regjistrin Civil Qendror, ose janë pajisur për herë të parë me dokumente të Republikës së Kosovës. Ndërsa, 46,917 votues janë larguar nga lista e votuesve, pasi që të njëjtit kanë vdekur apo kanë hequr dorë nga shtetësia.

Për zgjedhjet e 6 tetorit, votuesit kanë mundur të ushtrorjnë të drejtën e tyre të votës në gjithsej 895 Qendra të Votimit, respektivisht në 2,547 vendvotime. Krahasuar me zgjedhjet paraprake, ka pasur katër Qendra të Votimit më pak, kurse 42 vendvotime më shumë. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kishte marrë vendim për rritjen e numrit maksimal të votuesve në vendvotim në 950 votues, për dallim nga përcaktimi ligjor prej maksimalisht 750 votues për vendvotim.

Përgjatë periudhës së shërbimit të votuesve, janë parashtruar mbi 5 mijë kërkesa për ndërrimin e qendrave të votimit, prej të cilave pjesa më e madhe nëpërmjet aplikacionit 'online'.



Disa nga problematikat që kanë shoqëruar procesin e përpilimit të Listës Përfundimtare të Votuesve kanë qenë të ndërlikdhura me përfshirjen e personave të vdekur, por edhe mos përfshirjen e votuesve të cilët kanë nxjerrë së fundmi dokumente të Republikës së Kosovës.

Procesi i votimit jashtë vendit

Operacioni i votimit jashtë Kosovës, që njihet ndryshe si votimi me postë, kishte filluar më 30 gusht, kur ishte hapur periudha për aplikimin për regjistrim të votuesve jashtë vendit. Kjo periudhë, sipas planit të aktiviteteve, ka zgjatur deri më 10 shtator. Për përmbylljen e këtij procesi brenda afateve të parapara, KQZ-ja kishte marrë vendim për shtimin e stafit që është marrë me verifikimin e aplikacioneve dhe regjistrimin e votuesve jashtë vendit.

Numri i aplikacioneve për votim jashtë vendit ka shënuar rritje të ndjeshme krahasuar me ciklet e kaluara zgjedhore. Përgjatë periudhës për regjistrimin e votuesve për votim jashtë vendit, KQZ-ja ka pranuar 40,313 aplikacione. Mbi 85% e tyre janë pranuar përmes adresave elektronike të hapura nga KQZ-ja. Në këtë drejtim, është shënuar progres në procesimin e tyre, si dhe nuk janë shfaqur ankesa për bllokimin e serverëve, siç kishte ndodhur në zgjedhjet paraprake. Pjesa tjetër kanë aplikuar përmes postës, pjesa dërrmuese e të cilave nga Serbia, si dhe një pjesë e vogël e aplikacioneve kanë ardhur përmes faksit.

Nga numri i përgjithshëm i aplikacioneve të pranuar, janë aprovuar 35,087 prej tyre. Disa nga arsyet kryesore që kanë çuar në refuzimin e 5,226 aplikacioneve tjera, kanë pasur të bëjnë me mos vërtetimin e kriterit të zotësisë juridike apo identitetit të aplikuesve, si dhe që votuesit nuk kanë arritur moshën 18 vjeç në ditën e zgjedhjeve. Pesë shtetet me numrin më të madh të aplikacioneve të aprovuara janë Gjermania (11,449), Zvicra (9,842), Serbia (4,337), Austria (1,387) dhe Italia (1,137).

Numri i përgjithshëm i dërgesave nga jashtë vendit, të pranuar nga KQZ-ja është 15,794. Ky numër është pothuajse përgjysmë më i vogël sesa numri i aplikacioneve të aprovuara, por që numri i saktë i fletëvotimeve nuk mund të dihet ende, meqenëse në një dërgesë mund të ketë më shumë se një fletëvotim.

Në listën e votuesve jashtë vendit ishin përfshirë edhe dhjetëra votues të cilët, ndonëse fillimisht ishin refuzuar nga KQZ-ja, me vendim të PZAP-së ishin futur në listë. Të njëjtëve, në Listën Përfundimtare të Votuesve, në kolonat përkatëse iu është vendosur një shenjë për të pamundësuar keqpërdorimet eventuale në emër të tyre.

Fushata zgjedhore

Për zgjedhjet e jashtëzakonshme të 6 tetorit, KQZ-ja përcaktoi afatin kohor prej 10 ditësh për organizimin e fushatës zgjedhore e cila formalisht filloi më 25 shtator dhe përfundoi më 4 tetor. Si rëndom, në mungesë të sanksionimit ligjor, subjektet politike filluan aktivitetet e tyre parazgjedhore qysh nga shpallja e datës së zgjedhjeve.

Fushata zgjedhore në përgjithësi ishte dinjitoze dhe u zhvillua në frymë të qetë dhe konkurruese, me pjesëmarrje të konsiderueshme të qytetarëve dhe pa incidente madhore. Në komunat me shumicë serbe ku garuan koalicionet apo subjektet politike nga ky komunitet, fushata nuk ishte në përputhje me standardet për një garë të lirë dhe të barabartë. Subjektet politike garuese përballë Listës Serbe u intimiduan, ndërsa qytetarëve iu bë presion të votonin për Listën Serbe.

Vëzhguesit afatgjatë të DnV-së gjatë dhjetë ditëve monitoruan 787 aktivitete të subjekteve politike Tubimi publik ishte forma më e preferuar e të bërit fushatë nga subjektet politike. 83% e të gjitha



aktiviteteve zgjedhore të monitoruara ishin tubime publike, në të cilat morën pjesë rreth 270 mijë qytetarë. Në masë më të ulët u evidentuan aktivitete të llojit “derë më derë”, shtande në ambiente publike dhe takime me grupe të interesit.

Sikurse në të gjitha ciklet paraprake zgjedhore, edhe në këto ka mungesë të theksuar të transparencës lidhur me shpenzimet e subjekteve politike në fushatë. Aq më tepër, shpenzimet e bëra jashtë kornizës formale të fushatës zgjedhore, do të mbeten të paraportuara nëse subjektet politike vazhdojnë t’i keqinterpretojnë dispozitat ligjore lidhur me Raportin e Deklarimit Financiar të Fushatës së Subjektit.

Temat për të cilat subjektet garuese folën më së shumti në fushatë ishin ato për ekonomi, arsim dhe shëndetësi. Subjektet, vëmendje të veçantë i kushtuan edhe edukimit të votuesve (në 58.5% të aktiviteteve) me anë të ofrimit të shpjegimeve lidhur me mënyrën se si duhet të votohet.

Gjatë 10 ditëve të fushatës zgjedhore, subjektet politike në 53 raste kanë përdorur gjuhë ofenduese dhe fyese kundër rivalëve politik.

Sa i përket pjesëmarrjes së grupeve të ndryshme shoqërore në fushatën zgjedhore, është evidentuar që pavarësisht retorikës së shtuar të subjekteve politike për përfaqësim të barabartë gjinor, pjesëmarrja e grave si folëse (25.3%) ashtu dhe pjesëmarrëse në tubime (25%) mbetet e ulët. Gjatë kësaj fushate është shënuar një rritje e lehtë në pjesëmarrjen e grave, krahasuar me zgjedhjet parlamentare të vitit 2017. Gjithsesi, ky cikël zgjedhor dëshmoi se grave vazhdon të mos iu ofrohet hapësirë e barabartë për të shpalosur idetë e tyre, duke e bërë garën zgjedhore të pabarabartë dhe më pak të favorshme për gratë.

Pavarësisht se në Kosovë jetojnë mbi 200,000 persona me aftësi të kufizuara, pjesëmarrja e tyre në aktivitete zgjedhore mbetet tejet e ulët, meqë vetëm 247 persona morën pjesë në aktivitetet e monitoruara zgjedhore. Mungesa e infrastrukturës së duhur për qasje të personave me aftësi të kufizuara ka vështirësuar dhe më tej pjesëmarrjen e tyre në aktivitetet zgjedhore, meqenëse në 27.5% të aktiviteteve nuk është garantuar qasje adekuate për këtë kategori. Në këtë fushatë zgjedhore, vetëm katër persona me aftësi të kufizuara kanë qenë folës, në gjithsej katër raste.

Pavarësisht rregullës zgjedhore që sanksionon pjesëmarrjen e fëmijëve nën moshën 15 vjeçare, subjektet politike shfrytëzuan pjesëmarrjen e tyre duke tentuar të krijojnë avantazh politik. Prania e fëmijëve është evidentuar në çdo ditë të fushatës, me rreth 4,200 fëmijë të hasur në aktivitete zgjedhore. Prania e tyre ka qenë spontane në shumicën e aktiviteteve, ndërsa e organizuar në 28 raste.

Përkundër faktit që në kuadër të vendimit për shkurtimin e afateve për aktivitetet zgjedhore ishte shkurtuar edhe periudha e paralajmërimit të aktiviteteve nga 72 orë në jo më vonë se 24 orë para mbajtjes së tyre, rreth 17% e aktiviteteve zgjedhore nuk janë paralajmëruar në KKZ-të përkatëse.

Përdorimi i resurseve publike, financiare apo njerëzore nga subjektet politike në pushtet krijon avantazh të dallueshëm për ta dhe çrregullon parimin e garës së barabartë në mes të subjekteve. Edhe pse kufizimet ligjore janë në frymën e parandalimit të këtyre avantazheve dhe forcimit të integritetit dhe barazisë në zgjedhje, subjektet politike, sidomos ato në pushtet, qoftë në nivelin qendror apo atë lokal, kanë vazhduar shfrytëzimin e resurseve publike. Ky fenomen është evidentuar në gjithsej 38 aktivitete, në të cilat është evidentuar përdorimi i 93 veturave zyrtare dhe janë 124 raste tjera të pjesëmarrjes së shërbyesve publik.



Shpenzimet e subjekteve politike gjatë fushatës

Bazuar në listën preliminare të votuesve, më 31 gusht, KQZ-ja kishte marrë vendim për kufizimin e shpenzimeve të fushatës për subjektet politike. Shuma maksimale e shpenzimeve që mund të bëjnë subjektet politike, sipas këtij vendimi, ishte caktuar të jetë 986,233 euro, bazuar në formulën e shpenzimit të jo më shumë se 0.50 eurove për secilin votues të regjistruar.

DnV-ja para fillimit të fushatës kishte kërkuar nga subjektet politike të tregojnë për shumën që ata planifikojnë t'i shpenzojnë në fushatë, mënyrën e financimit, udhëheqësit e fushatës etj. Kjo u bë përmes dërgimit të një pyetësi elektronik tek të gjitha subjektet politike në garë. Këtij pyetësi i janë përgjigjur pozitivisht vetëm pesë nga 26 subjektet politike të cilave iu është dërguar, që konfirmon mungesën e transparencës së tyre karshi shpenzimeve të fushatës.

Gjatë dhjetë ditëve të fushatës, DnV-ja ka monitoruar shpenzimet e subjekteve politike për organizimin e aktiviteteve të fushatës zgjedhore. Gjatë tre ditëve të para të fushatës, DnV-ja ka evidentuar shpenzime lidhur me aktivitetet zgjedhore në vlerë prej 1 milionë e 65 mijë euro. Në tre ditët pasuese kjo vlerë ka rënë në rreth 504 mijë euro, dhe në tre ditët e fundit shpenzimet e evidentuara ishin 535 mijë euro. Pra, përlllogaritjet e shpenzimeve për organizimin e aktiviteteve zgjedhore të monitoruara nga DnV-ja vlerësohen të jenë rreth 2 milionë e 293 mijë euro. Në përlllogaritje të shpenzimeve janë marrë parasysh çmimet mesatare të tregut. Këtu nuk përfshihen zbritjet e mundshme të çmimeve nga operatorët ekonomik që ofrojnë për subjektet politike apo kandidatët për deputet.

Vëzhguesit e DnV-së, përkritazi me monitorimin e ngjarjeve të organizuara nëpër komuna, kanë përcjellë edhe minutazhën reklamuese të subjekteve politike nëpër mediat kryesore që operojnë në Kosovë. Në bazë të përlllogaritjeve, subjektet politike kanë shpenzuar rreth 249 mijë e 894 euro për spote reklamuese dhe 328 mijë e 650 euro për transmetim të tubimeve nëpër media të ndryshme, gjatë 10 ditëve të fushatës zgjedhore.

Monitorimi i mediave gjatë fushatës

Gjatë fushatës, Demokracia në Veprim ka monitoruar televizionet (kronikat zgjedhore dhe spotet reklamuese), 'livestream' nga portalet, faqet zyrtare të partive politike dhe faqet zyrtare të kandidatëve për postin e kryeministrit, në rrjetin social Facebook.

Nga monitorimi që iu është bërë tetë kanaleve televizive (gjashtë shqiptare dhe dy serbe), del se këto medime në kronikat e tyre zgjedhore kanë ofruar hapësirë të përafërt për subjektet e mëdha politike, ndërkaq më pak hapësirë për subjektet e vogla. Disa nga kanalet televizive kanë shfaqur edhe spote reklamuese të kandidatëve të subjekteve politike në kohën kur kishte debate zgjedhore. Gjetjet tregojnë që më së shumti mbulueshmëri tek televizionet në kronika zgjedhore ka pasur Lidhja Demokratike e Kosovës me 206 minuta, ndjekur nga Partia Demokratike e Kosovës me 201 minuta, Lëvizja Vetëvendosje me 197 minuta, Koalicioni AAK-PSD me 185 minuta, Koalicioni NISMA-AKR-PD me 160 minuta, Lista Serbe me 122 minuta dhe partitë tjera me 93 minuta.

Sa i përket aspektit gjinor, të dhënat kanë treguar që kandidatët burra dhe kandidatet gra nuk janë paraqitur barabartë gjatë fushatës. Në matjen e bërë për kronikat zgjedhore, minutat që kanë pasur gratë kandidate në kronika janë vetëm 17%, në krahasim me 83% të minutave të burrave. Përderisa partitë nuk i kanë dhënë shansin grave kandidate për promovim, ka pasur raste kur mediat ua kanë përmendur emrin grave kandidate, por rrallëherë kanë shfaqur incizime kur ato kanë folur.



Në kuadër të matjes së zërit të deputetëve dhe zërit të liderit (kandidatëve për kryeministër) që kanë folur, renditja ndryshon nga numri i përgjithshëm i minutave për parti. Në këtë kontekst, PDK-ja del e para me 86 minuta kushtuar liderit dhe 70 minuta për kandidatët për deputetët. LVV-ja është e dyta me 77 minuta për liderin dhe vetëm 31 minuta për kandidatët për deputetët. LDK-ja është e treta me 68 minuta për liderin dhe me vetëm 3 minuta për kandidatët për deputetët. i katërti në radhë është koalicioni AAK-PSD me 51 minuta për liderin dhe 47 për kandidatët për deputetët. Koalicioni tjetër, NISMA-AKR-PD ka 48 minuta për liderin e tyre dhe 36 minuta për kandidatët për deputetët. Në fund renditet Lista Serbe me vetëm 4 minuta për liderin e saj dhe 54 minuta për kandidatët për deputet.

Edhe tek spotet televizive, që varen më shumë nga vetë partitë, është evidentuar një diskrepancë e madhe në përfaqësim të barabartë të kandidatëve burra dhe atyre gra. Vetëm 16% e spoteve kanë pasur mbulueshmëri për gratë kandidate për deputete. Ndërkaq sa i përket spoteve reklamuese për kandidatët dhe për liderët, prijnë spotet për liderët krahasuar me kandidatët për deputetët. Lista Serbe nuk ka pasur spote reklamuese as për liderin dhe as për kandidatët për deputetët. Po ashtu nga monitorimi i DnV-së del se lideri i LVV-së nuk ka transmetuar asnjë spote reklamues.

Sa i përket monitorimit të tubimeve të partive politike të transmetuara nëpër televizionet e monitoruara (RTK1, KTV, Klan Kosova, RTV 21, TV Dukagjini, T7, RTK2 dhe TV PULS), hapësirë më të madhe ka pasur PDK-ja me 1,585 minuta gjatë 10 ditëve zyrtare të fushatës zgjedhore, pasuar nga koalicioni AKK-PSD me 1,521 minuta, LDK-ja me 1,210 minuta, LVV-ja me 540 minuta, Lista Serbe me 237 minuta dhe NISMA AKR-PD me 181 minuta.

Nga monitorimi i transmetimeve direkte përmes faqeve të Facebook-ut të portaleve, prin LDK-ja me 2,631 minuta nga katër portale, koalicioni AAK-PSD me 2,208 minuta nga pesë portale, PDK-ja me 1,702 minuta nga gjashtë portale, përfshirë faqen zyrtare të RTK-së, e cila ka transmetuar vetëm tubimet e kësaj partie. Nisma-AKR-PD kanë 937 minuta 'livestream' nga katër portale, ndërsa LVV-ja ka vetëm 138 minuta nga vetëm një portal. Subjektet tjera politike nuk kanë pasur transmetim të drejtpërdrejtë në portale.

Në lidhje me numrin e postimeve në faqet zyrtare të partive politike prin koalicioni NISMA-AKR-PD me 245 postime, ku nga këto postime vetëm 16 postime janë për gratë kandidate. I dyti është koalicioni AAK-PSD me 244 postime, prej të cilave vetëm 24 postime janë për gratë. Më tutje renditet LDK-ja me 107 postime, nga të cilat 62 janë për gratë (përfshirë edhe kandidaten për kryeministër), LVV-ja me 86 postime, nga të cilat 29 për gratë, si dhe PDK-ja me gjithsej 65 postime, prej të cilave vetëm pesë janë për gratë kandidate.

Kur jemi tek monitorimi i rrjeteve sociale, DnV-ja ka monitoruar edhe faqet zyrtare të kandidatëve për kryeministër. Ramush Haradinaj prin me numrin më të madh të postimeve, me gjithsej 138 sosh, pasuar nga Kadri Veseli me 89 postime, Vjosa Osmani me 78 postime, Fatmir Limaj me 72 postime, si dhe Albin Kurti me 42 postime.

Vëzhguesit e zgjedhjeve

Zgjedhjet e 6 tetorit kanë zgjuar interes të madh të publikut, duke ndikuar kështu në rritjen e numrit të vëzhguesve. Për vëzhgimin e zgjedhjeve, Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim kishte rekomanduar për akreditimin e 34,596 vëzhguesve, të cilët ishin akredituar në grupe të ndryshme. Për vëzhgimin e zgjedhjeve janë akredituar vëzhgues nga pesë ambasada, një konsullatë, gjashtë organizata ndërkombëtare, 29 organizata vendore, 22 subjekte politike, si dhe rreth 60 medime vendore dhe ndërkombëtare.



Për këto zgjedhje, Demokracia në Veprim ka pasur të akredituar gjithsej 3,113 vëzhgues, duke qenë kështu misioni më i madh i vëzhgues në vend, pa përfshirë subjektet politike. Demokracia në Veprim ka pasur rreth 10% të numrit të përgjithshëm të vëzhguesve.

Me ftesë të Presidentit të Kosovës, Bashkimi Evropian ka dërguar në Kosovë një mision për vëzhgimin e zgjedhjeve (EU EOM), të cilët në ditën e zgjedhjeve kanë qenë prezent me 108 vëzhgues në nivel vendi.

Dita e Zgjedhjeve – Votimi dhe Numërimi

Dita e Zgjedhjeve vlerësohet e qetë dhe pa incidente të theksuara. Vëzhguesit e DnV-së kanë monitoruar procesin e votimit dhe numërimit në të gjitha 2,547 vendvotimet në nivel vendi.

Pothuajse të gjitha vendvotimet janë hapur me kohë. Në vetëm 2.6% të vendvotimeve janë shënuar vonesa në hapje, për shkak të mosardhjes me kohë të anëtarëve të Këshillave të Vendvotimit apo vonesave në shpërndarjen e materialeve zgjedhore. Prania e materialeve propaganduese në afërsi të Qendrave të Votimit është hasur në 7% të të gjitha qendrave në nivel vendi, duke shënuar kështu dyfishim të kësaj parregullsie krahasuar me zgjedhjet parlamentare të vitit 2017.

Rreth 30% e Qendrave të Votimit vazhdojnë të mos kenë qasje adekuate për personat me aftësi të kufizuara fizike. Ndonëse është shënuar avancim i lehtë i përfaqësimit të grave në trupat për administrimin e zgjedhjeve, sërish përqindja e tyre mbetet relativisht e ulët. Nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillave të Vendvotimit, rreth 35% e tyre kanë qenë gra. Kjo përqindje nuk përmbush zotimin paraprak të subjekteve politike për garantim të përfaqësimit të grave në trupak menaxhuese të zgjedhjeve, me së paku 40% të përbërjes së këtyre trupave.

Procesi i votimit në përgjithësi ka rrjedhur normalisht dhe në frymë të qetë, duke u mos u evidentuar asnjë rast i mbylljes së vendvotimeve si rezultat i ndonjë incidenti serioz. Në një shkallë relativisht të lartë (18 mijë raste), votuesit kanë hasur vështirësi në gjetjen e vendvotimeve adekuate ku ata është dashur të votojnë.

Udhëzimi i KQZ-së lidhur me dokumentet e vlefshme të identifikimit, ka mënjanuar dukurinë e identifikimit të votuesve me dokumente të pavlefshme, sidomos të shteteve tjera. Sidoqoftë, fenomen i shfaqur në këto zgjedhje ishte identifikimi i votuesve me dokumente të vlefshme, por me afat të skaduar.

Votimi me asistencë, që është kategori e lejuar nën kufizime të caktuara për situata specifike, siç parashihet edhe në dispozitat përkatëse, ka qenë dukuri shumë e shprehur dhe e përhapur njëtrajtshëm në gjithë vendin. Rreth 60 mijë raste të ofrimit të asistencës janë evidentuar nga vëzhguesit e DnV-së gjatë gjithë ditës. Përkundër kufizimeve ligjore, nuk janë përjashtuar rastet kur anëtarët e KVV-ve kanë asistuar votuesit për të votuar ose kur një person ka asistuar më shumë se një votues.

Në kuadër të parregullsive që ndërlidhen me cenimin e fshehtësisë së votës, fotografimi i votës është evidentuar në gjithsej 172 raste. Qëndrimi i më shumë se një personi prapa kabinës së votimit është evidentuar në 240 raste, ndërsa bërja publike e votës nga votuesi është evidentuar në 73 raste tjera. Procesi i votimit është përmbyllur në kohë dhe pa ndonjë incident serioz në këtë periudhë. Nga vëzhguesit nuk është raportuar ndonjë rast kur votuesit që kanë qenë në radhë duke pritur për të votuar para orës 19:00 nuk janë lejuar të votojnë. Përgjithësisht i rregullt ka qenë edhe procesi i numërimit, mirëpo janë shënuar incidente të vogla, të cilat janë trajtuar nga Policia e Kosovës.



Sipas të dhënave preliminare, në zgjedhjet e 6 tetorit, të drejtën e votës e kanë ushtruar rreth 850 mijë qytetarë, apo shprehur në përqindje 44%. Krahasuar me zgjedhjet paraprake është shënuar rritje prej rreth 100 mijë votuesish. Sipas raportimeve të DnV-së për intervale kohore, dalja në zgjedhje deri në orën 09:30 ka qenë rreth 6%, deri në orën 13:00 rreth 19%, ndërsa deri në orën 17:00 rreth 38%. Për garantimin e sigurisë së procesit zgjedhor, gjatë ditës së zgjedhjeve kanë qenë të angazhuar mbi 100 prokurorë, të cilët kanë reaguar në mënyrë efektive në rastet e shkeljeve të dispozitave ligjore lidhur me zgjedhjet. Ndërsa, 15 gjyqtarë tjerë kanë qenë të caktuar si gjyqtarë kujdestarë, për të trajtuar kërkesat e prokurorëve për caktimin e masave ndaj personave që kanë kryer vepra penale të ndërlydhura me shkeljet zgjedhore.

Rezultatet preliminare

Bazuar në rezultatet preliminare të shpallura nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me 98,15% të vendotimeve të procesuara, rezultatet për subjektet politike janë si në vijim:

Lëvizja Vetëvendosje prin me 25,56%, pasuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës me 24,87%, Partia Demokratike e Kosovës me 21,14%, Koalicioni AAK-PSD me 11,54%; Lista Serbe me 6,69%, Koalicioni NISMA-AKR-PD me 4,89%, si dhe partitë tjera që kanë fituar 5.31%.

Kërkesa e anëtarit të koalicionit PAN në KQZ, dy ditë para zgjedhjeve, për numërimin e të gjitha rezultateve të kandidatëve edhe në QNR, nuk ishte miratuar nga KQZ-ja.

Drejtësia zgjedhore

Deri në ditën e heshtjes zgjedhore, në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia janë parashtruar 86 apele dhe 143 ankesa. Prej 86 apeleve, 72 janë refuzuar, dy janë tërhequr ndërsa 12 janë pranuar. Në anën tjetër, nga gjithsej 143 ankesa, 60 janë pranuar si të bazuara, 42 janë refuzuar, kurse 41 të tjera janë ende në periudhë të shqyrtimit. PZAP-ja, për shkak të shkeljeve të Kodit të Mirësjelljes gjatë fushatës zgjedhore, ka shqiptuar gjoba për 10 subjekte politike në vlerë të përgjithshme prej mbi 240 mijë euro.

Demokracia në Veprim, përgjatë monitorimit të 10 ditëve të fushatës zgjedhore të subjekteve politike, ka dorëzuar në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) gjithsej 26 ankesa, prej të cilave 19 janë miratuar (shuma 88,050 euro), dy janë refuzuar dhe pesë të tjera janë në ende në shqyrtim. Shuma e përgjithshme e gjobave të shqiptuara ndaj subjekteve politike si rezultat i ankesave të DnV-së është 88,050€.

Koalicioni i organizatave vendore të shoqërisë civile për vëzhgimin e zgjedhjeve "Demokracia në Veprim" ka angazhuar rreth tre mijë vullnetarë për të vëzhguar në tërësi procesin zgjedhor për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, të mbajtura më 6 tetor.

Fushata parazgjedhore është vëzhguar nga 72 vëzhgues të akredituar afatgjatë të DnV-së, të cilët kanë përcjellë tubimet publike, takimet me grupet e shënjestruara, vizitat në shtëpi private dhe aktivitetet tjera të subjekteve politike. DnV ka monitoruar edhe mbledhjet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Komisioneve Komunale Zgjedhore. Në ditën e zgjedhjeve, DnV ka pasur të angazhuar rreth 2,700 vëzhgues në terren, duke pasur të mbuluara të gjitha vendvotimet në nivel vendi, si dhe duke raportuara në baza të shpeshta kohore për të gjitha zhvillimet lidhur me procesin zgjedhor. Në Qendrën e Thirrjeve, DnV ka pasur të angazhuar edhe mbi 170 vullnetarë tjerë, të cilët kanë mbledhur dhe procesuar të dhënat e marra nga terreni.

DnV do të përcjellë nga afër edhe procesin e numërimit në Qendrën e Numërimit të Rezultateve dhe shqyrtimin e ankesave eventuale në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, deri në certifikimin përfundimtar të rezultateve.

Të gjeturat e detajuara nga procesi i vëzhgimit para, gjatë dhe pas ditës së zgjedhjeve, do të paraqiten në raportin përfundimtar të vëzhgimit, i cili do të publikohet pas certifikimi të rezultateve.